



## P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) - Rahovec, e mbajtur më 28.1.2023, me fillim në orën 15:30. Mbledhjen e kryesoit Kryetari Komunës, Smajl Latifi. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes është. Kryetari: Më lejoni t'i përshëndes të gjithë anëtarët e KKSBS-së, përshëndes nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, z.Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-së, FSK-së dhe të medieve. Është mbledhja e parë e rregullt për vitin 2023. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

### Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i informatës së aktiviteteve të KKSBS-së për vitin 2022;**
- 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë, në territorin e komunës së Rahovecit;**

-Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak;

-Siguria në trafik

-Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i planit për siguri në shkolla.

-Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit, në Komunën e Rahovecit.

-Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit

-Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.

- 4. Të ndryshme.**

**Kryetari:** Atëherë, ky është rendi i ditës për sot, nëse dikush ka diçka për të shtuar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Faleminderit, konstatojmë që është miratuar rendi i ditës për këtë takim.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryetari:** Nëse dikush ka ndonjë koment, plotësim apo vërejtje rreth procesverbalit?... Kush është për miratimin e kësaj pike?... Faleminderit, pika e parë e rendit të ditës miratohet.

**2. Shqyrtimi i informatës së aktiviteteve të KKSBS-së për vitin 2022;**

**Kryetari:** Atëherë, ne kemi mbajtur takime të rregullta gjatë vitit 2022, ka procesverbale dhe incizime për të gjitha mbledhjet. Në këto takime kemi diskutuar për sferën e sigurisë në komunën tonë, duke nxjerrë vlerësimë, komente, konkluzione dhe njëkohësisht vendime në shërbim të institucioneve të komunës për të

ruajtur stabilitetin e përgjithshëm në komunën tonë. Bashkë me stacionin policor, OJQ-të, inspektorët e komunës, bashkësitë fetare, me QPS-në, me të gjitha drejtoritë, kemi bërë një punë të mirë gjatë vitit 2022, duke u karakterizuar si vit i qetë dhe stabil, sa i përket sigurisë në komunë. Kemi instaluar kamera në territorin e Rahovecit. Kemi bërë diçka edhe me qentë endacak, duke e lidhur një kontratë me shërbimin veterinar. Poashtu kemi bërë diçka edhe me grumbullimin e mbeturinave dhe tani janë dy operatorë që në mënyrë të rregullt i mbledhin mbeturinat dhe i depozitojnë në deponinë e Landovicës. Me operatorët kemi marrëveshje për trajtimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve, hapjen e kanaleve të kullimit, duke e falënderuar edhe FSK-në për ndihmë. Madje, kjo punë ka ndikuar që në vërvshimet e radhës, që kanë ndodhur, të jemi të mbrojtur në masë të madhe. Rreth vërvshimeve të fundit që kanë ndodhur në Skenderaj, Klinë, Mitrovicë, Podujevë, Istog dhe Pejë, komuna jonë ka formuar një "Fond të Solidaritetit", ku edhe roli i anëtarëve të KKSB-së është i nevojshëm në këtë solidarizim të qytetarëve të vullnetit të mirë të Rahovecit, për t'i ndihmuar zonat e përmbytura. Na kanë mbetur edhe shumë sfida dhe veprime intensive të tjera. Fjalën ia jap komandantit për informata rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2022.

**Fazli Morina:** I nderuari kryetar, pjesëtarë të FSK-së, LMT-së, OQJ-së, të nderuar anëtarë të KKSB-së. Shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë ata që gjatë tërë vitit që e lamë pas, na kanë përkrahur në të gjitha aspektet. Para jush, do t'i pasqyroj të gjitha aktivitetet e stacionit policor në Rahovec për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2022. Kryesisht gjatë tërë vitit kemi pasur një situatë të qetë dhe stabile. Janë implementuar dy strategji afatgjate, 11 urdhra operativë, 73 plane operative, 52 plane të veprimit dhe 9 projekte të prezantimeve në shkolla. Sa u përket veprave penale të iniciuara nga stacioni policor në Rahovec, gjatë kësaj periudhe janë të regjistruara gjithsej 464 raste vepra penale dhe 113 incidente jopenale. Zbulueshmëria në total e të gjitha rasteve është 64%. Lëndime të rënda: 5 raste, të lehta: 42 raste, vjedhje: 43 raste, vjedhje të rënda: 72 raste, dhuna në familje: 53 raste, dhënie e ryshfetit: 1 rast, 6 raste të narkotikëve, pengimi i personit zyrtar në krye të detyrës zyrtare: 3 raste, sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare: 4 raste, tentim vrasje: 4 raste, janë 27 armë të konfiskuara pa leje dhe 531 fishekë, janë kryer 24 bastisje, 219 persona janë arrestuar gjatë vitit 2022, 108 persona të ndaluar në mbajtje 48 orë, 269 urdhëresa të gjykatës. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka pasur 89 raste të aksidenteve me dëme materiale, 19 raste aksidente me lëndime të rënda, 126 raste të aksidenteve me lëndime të lehta, për fat të keq, 5 raste të aksidenteve me fatalitet. Kalojmë te siguria në komunikacion rrugor e cila është stabile por mund të bëhet edhe më e kënaqshme. Janë dhënë 8519 gjoba, 362 tiketa janë vozitje pa patent shofer, 12 nën ndikim të alkoolit, 40 masa të ndalimit të drejtimit të automjetit, 1485 tiketa për parking të palejuar, 48 gjithsej për prishje të rendit dhe të qetësisë publike. Te siguria në shkolla janë 22 raste, prej tyre, 1 rast sulm, 1 rast sulm seksual, 3 raste mbajtje në pronësi të paautorizuar të armëve, 5 raste asgjësim i pasurisë, 4 raste kanosje, 3 raste lëndim i lehtë trupor, 1 rast vjedhje, 1 rast vjedhje në tentativë, 2 raste vjedhje e rëndë, 1 rast keqtrajtim gjatë detyrës zyrtare.

**Kryetari:** Faleminderit komandant, për paraqitjen e aktiviteteve që e kanë karakterizuar vitin 2022.

Informatën e aktiviteteve të KKSB-së e keni para vetes, të gjitha angazhimet e KKSB-së, për secilën mbledhje.

E kemi organizuar Festën e vjeljes së rrushit pa ndonjë incident serioz, përvèç atyre sporadike. Kemi bërë punë që u kanë shërbyer edhe komunitetetë që janë pakicë në komunën tonë. Do të vazhdohet me funksionalizim dhe zgjerim të kamerave të sigurisë kudo në komunë dhe besoj që nuk do të ketë vend për shkelësit e ligjit.

### **3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;**

**Fadil Sylka:** Përshtendetje për të gjithë. Mendoj rreth punimeve në sheshin apo parkun që po bëhet në qendër, kemi ngulfatje të komunikacionit. Një pjesë që është aty në formë të "hundës" duhet të zgjerohet për dy metra, që qarkullimi të lirohet. E propozoj këtë zgjerim.

**Kryetari:** Punimet në sheshin e qendrës nuk kanë arritur as te gjysma, rifillojnë shumë shpejt. Do të ketë sinjalistikë, vende për njerëzit me nevoja të veçanta, zgjerimi ka ndodhur sepse 6 metra ka qenë, tani është shtatë. Për zgjerime të tjera, do të bashkëbisedojmë me operatorin. Automjetet për parking, aty nuk e kanë vendin. Jemi i vetmi qytet që ende nuk kemi kontratë me ndonjë operator për parking me pagesë. Parkingjet janë falas. Ne jemi të obliguar që ndaj atyre që jetojnë aty, të kemi konsideratë për parkingje.

**Vjollca Gurgule:** Përshëndetje kryetar, nënkyretar, komandant i polisë, drejtore, drejtoresha, kolegë. Për kolegët e KKSBS-së, ata të cilët nuk janë në dijeni, i përgëzoj edhe njëherë për vendin e parë në raportin e transparencës ku edhe kam qenë pjesë aty. Një njoftim tjetër është, SHL-ja ka fituar një projekt të vogël për një aktivitet që e kemi pasur me të rinxjtë. Faleminderit edhe drejtorit Përparim për ndihmën. Kompania që e ka fituar të drejtën për vendosjen e këtyre dy kërkësave nga unë (një polic i shtrirë dhe një zebër) së shpejti do t'i vendosë. Gjithashtu e kemi fituar një miniprojekt për ngjyrosjen e një trafoje të rrymës në qendër të qytetit, me mesazhin që të rinxjtë të lexojnë më shumë.

**Kryetari:** Ndoshëta duhet edhe një pëlqim nga drejtori i Urbanizmit, edhe pse nuk besoj që ka telashe, po më vije mirë që jeni aktiv si SHL. Çdo OJQ që është aktive, e ka përkrahjen e Komunës së Rahovecit.

Tani e tutje do të keni edhe dy nënpika permanente në mbledhjet e KKSBS-së, mbrojtja e lumenjve që rrjedhin, qoftë nga ujërat e zeza, mbeturinat dhe degradimet të cilat po i bëjnë dëm shumë të madh qytetarëve. Pika e dytë, siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. Roli i KKSBS-së është i veçantë, bashkë me punën e inspektoriatit, e cila do të jetë e pakompromis me keqbërës dhe me ata që tentojnë ta degradojnë mjedisin. Nuk do të ketë kompromis nëse hetohet që ka barna me afat të skaduar, produkte ushqimore me afat të skaduar. Ne si KKSBS, mund të raportojmë, më pas inspektoriati do t'i vizitojë qendrat tregtare, dyqanet etj... Një paradox është që dikush gjuan mbeturina aty ku nuk e kanë vendin, e ne si komunë hargjojmë para për t'i hequr ato.

**Nysret Abazibra:** Faleminderit kryetar! Përshëndetje për juve dhe për të gjithë anëtarët. Herën e kaluar e kemi ngriti çështjen e ndriçimit në lagjen e shkollës "Gëzim Hamza", ende nuk është përfunduar edhe pse na është premtuar që javën tjetër do të fillojë. Po ju bëj me dije që kjo punë nuk është kryer dhe është shqetësuese nëse fëmijët tanë janë të rrezikuar çdo natë. Çështja tjetër ka të bëjë me kujdesin ndaj konsumatorëve në aspektin e çmimeve. Kemi shumë lokale në Rahovec që nuk kanë çmimore dhe duhet ta pyes "sa kushton kjo?", prandaj mendoj që është shumë parimore që duhet të obligohen të gjitha bizneset që t'i vendosin çmimoret në atë që shesin. Do të ishte edhe një shembull i mirë për komunën që i mbron interesat e qytetarëve.

**Kryetari:** Faleminderit Hoxhë! Është një mekanizëm që quhet "mekanizëm që mbron konsumatorin", por ka njerëz që nuk janë në dijeni. Komuna është e hapur për çdo gjë dhe ka mundësi për kapacitete vendimmarrëse me vizita dhe gjoba, por mund ta lajmërojmë edhe ATK-në, për ata që nuk i mbajnë çmimet ose nuk e kanë flamurin afér që konsumatori të jetë në dijeni se prej nga vjen artikulli. Ju ftoj me qenë bashkëpunues.

Sa i përket ndriçimit publik, kemi lidhur kontratë me një kompani serioze që do ta digitalizoje ndriçimin publik, secila shtyllë do ta ketë një njësi digitale. Jemi të vetëdijshëm për lagjen e epërme, ndriçimi është prishur ose vjedhur. Kompania do të operojë shumë shpejt.

**Beqir Hamza:** Përshëndetje për të gjithë! Rreth mbrojtës së lumenjve dhe siç e cekët që po krijon një kostoshtesë për pastrimin e tyre; e kam një propozim, kompanitë e pastrimit të cilat operojnë në komunën e Rahovecit, ta caktojnë një ditë në muaj, apo kur ta shohin të arsyeshme, që ta kenë një ditë të caktuar për mbledhjen e mbeturinave më të mëdha (pajisjet e ndryshme që gjuhen në lumenj, përrrocka), kjo do të ishte një masë preventive që konsumatori mos t'i gjuajë atje, por ta presë ditën kur operon kompania.

**Milan Stanojeviq:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, poash tu falënderoj të gjithë anëtarët e KKSBS-së për kontribut gjatë vitit 2022, kryetarin dhe komandantin për punën e bërë. I kam tri kërkesa, e para ka të bëjë me qentë endacak në lagjen e epërme (rrezik dhe panik për fëmijët), e dyta ka të bëjë me vendosjen e pengesave në rrugë dhe e treta rreth vjedhjeve që kanë ndodhur në këtë muaj (janar), janë dy raste që kanë ndodhur dhe familjen nuk e kanë paraqitur rastin për shkak të frikës për paraqitjen e këtij rasti.

**Kryetari:** Faleminderit! Sa i përket pengesave në rrugë, ne kemi kontratë dhe Përparimi le të merret vesh me Afrim Limanin që është menaxher aty dhe le t'i shikojnë mundësitë për vendosjen e pengesave. Për qentë endacakë, i kemi marrë disa iniciativa me veterinarët, por janë të pamjaftueshme. Është lidhur një kontratë nga shteti për trajtimin dhe rehabilitimin e qenve endacakë. Çështje e tretë e Milanit ka të bëjë me policinë, për atë arsyë më herët fola edhe për kamerat e sigurisë. Sa i përket Beqës, rreth mbeturinave inerte, e kemi një deponi legale. Nesër zyrtarisht do ta marrim edhe një kamion (130.000 euro) i cili mund t'i kapë

4-5 kontinierë, e më vonë edhe një kamion-fshesë, që do të shtohet edhe një dëshmi shtesë që mjedisin e kemi prioritet.

**Fazli Morina:** Përshëndetje i nderuari Milan! Sa u përket vjedhjeve, ka rënje të rasteve, mirëpo vjedhjet janë vazdimësi dhe puna jonë është t'i hetojmë, dhe shkelësit t'i dërgojmë para drejtësisë. Me keqardhje po them që rastet e tilla është dashur të raportohen, sepse nuk kemi informata që kanë ndodhur këto raste, nuk e dimë rastin e vjedhjes, vjedhje në tentativë, e rëndë apo e lehtë, as nuk mund të konkludojmë as paragjykojmë. Mosdeklarimi i rastit, në vete, është veprë penale, sepse automatikisht kalon si i dyshimtë dhe mund të iniciohet si rast. E keni numrin zyrtar të policisë, por edhe numrin tim personal, do të përgjigjem në çdo kohë.

**Kryetari:** Kjo është mbledhja e parë për këtë vit dhe viti 2022 ka qenë një vit i rëndë me rritje të çmimeve. Tani është kjo rritja e tatimit në pronë. Komuna e Rahovecit, në këtë sallë të kuvendit, çdo vit në shtator e cakton normën tatimore sipas ligjit. Norma tatimore 2021, 2022, 2023, nuk ka ndryshuar dhe është me vlerën minimale 0.16%. Ministria e Financave, ka formuar një komision që ka bërë rivlerësimin e pronave në Republikën e Kosovës. Si rezultat, vlera financiare, secilës pronë i është rritur 100%. Vendimi duhet të pezullohet dhe rritja duhet të bëhet me përshkallëzim. Pra, përgjegjësia e komunave është norma tatimore, e jo vlera financiare e tatimit në pronë. Ne do të tentojmë mos të na vijnë shpejt faturat e reja me rritje. Ky është tatim obligativ i rregulluar me ligj, paguani faturat para se të vijnë të rejat me rritje 100%.

**Shaip Shala:** Faleminderit kryetar! Këtë "notes" e kam për hyrje - dalje të pensionit, e tani i vendosi edhe 10 euro për tatim në pronë.

**Kryetari:** Për ata që nuk i kanë mundësitë, ne e kemi ndërtuar një mekanizëm që iu mundëson atyre pagesën pjesë – pjesë.

**Fazli Morina:** U anashkalua edhe një rast i vjedhjes, meqë u përmend këtu një rast me një shumë të mëdha parash. Është shumë e vërtetë që kanë ndodhur dy raste, vjedhje me depërtim me stoli ari, shumë të konsiderueshme parash. Moralisht po e ndiej një përgjegjësi për të gjithë. Shumë shtëpi kanë stoli dhe shuma të mëdha të parave në shtëpi dhe ndodh një bastisje e më pas duhet të jepni llogari prejardhjen e tyre. Më befason fakti sesi mbahen të gjitha ato para në mënyrë aq të pasigurt. Të paktën mos t'i keni vend e pavend, por depononi aty ku është vendi.

**Kryetari:** Faleminderit! Po punojmë bashkë me ministrinë, duke u bazuar në gjendjen ekonomike, që të paktën ky vendim të mos jetë në zbatim. Qëllimi i komunës është t'i mbledhë tatimet, pa i ngarkuar qytetarët, sepse tatimet e mbledhura kthehen në investime për ta. Faleminderit të gjithëve për kontributin, shpresojmë që viti 2023 të jetë më i frytshëm për të gjithë.

Mbledhja përfundoi në orën 16:35

Procesmbajtësi

Alijan Krasniqi



Kryetari i Komunës

Smajl Latifi